



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/07/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga G.Ç ndaj gjyqtarit K.K, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 11.04.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga G.Ç ndaj gjyqtarit K.K, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës G.Ç përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit K.K, ankesë kjo e cila është dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 25.03.2024.

Parashtruesi i ankesës G.Ç ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit K.K me pretendimet se i njëjti ka bërë shkelje serioze gjatë trajtimit të lëndës për padinë e datës 24.05.2022, ku sipas tij me datë 12.12.2022 Gjykata Themelore në Prishtinë i ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës a po që i njëjti të dorëzojë dëshmi për lirimin nga pagesa e taksës, ku i njëjti në afat ligjor ka dorëzuar në gjykatë dëshmi me sqarime për lirim nga taksa gjyqësore duke pretenduar se një pagesë prej 50Euro në këtë inflacion nga një pagë minimale do të rrezikonte ekzistencën e drejtpërdrejtë të fëmijëve pasi që është bartës i fëmijëve, gruas dhe vetës. Tutje i njëjti ka deklaruar se pas këtij veprimi të tij, gjyqtari K.K ka nxjerrë vendimin A.nr.1255/22 të datës 22.12.2022 duke e konsideruar të tërhequr padinë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i ankesës – paditësi ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, ku e njëjta e ka anuluar Aktvendimin A.nr.1255/22 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim. Tutje i njëjti deklaron se edhe pas vendosjes së Gjykatës së Apelit dhe rekomandimeve të dhëna në vendim, gjyqtari K.K përsëri nxjerr vendim duke refuzuar kërkesën për lirim nga taksa dhe duke e konsideruar të tërhequr padinë për mos pagesë të taksës. Pas atakimit të serishëm të këtij vendimi nga ana e paditësit, Gjykata e Apelit përsëri e ka kthyer çështjen në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale. Në fund ka kërkuar që të aprovohet në tërësi ankesa e paditësit, gjyqtari K.K të përjashtohet dhe të caktohet një gjyqtarë tjetër për trajtimin e këtij rasti, si dhe i njëjti të dënohet për shkelje procedurale, neglizhencë dhe një anshmëri.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se të njëjtat i kundërshton në tërësi, pasi që sipas tij këto pretendime janë të pavërteta, të pasakta dhe tendencioze. Gjyqtari ka deklaruar se pas shqyrtimit paraprak të padisë, si rregull veprimi i parë procedural është pagesa e taksës gjyqësore për padi, gjë të cilën paditësi/ankuesi nuk e ka bërë asnjëherë. Tutje ka deklaruar se me Vendimin e fundit të Gjykatës së Apelit AA.nr.322/2023 të datës 07.02.2024, është miratuar ankesa e paditësit dhe çështja është kthyer në rivendosje dhe se lënda vazhdon të jetë në shqyrtim paraprak, përkatësisht në fazën e veprimeve procedurale, pra është lëndë në trajtim e sipër dhe në lidhje me kërkesën e paditësit për lirim nga taksa, do të vendoset shumë shpejtë, dhe po ashtu me datë 21.03.2024 është dërguar aktvendimi për përgjigje në padi tek e paditura. Pretendimet e paditësit për shkelje procedurale, sipas ligjit janë vlerësuar dhe vlerësohen nga Gjykata e Apelit me procedurën e rregullt sipas ankesës. Tutje ka deklaruar se paditësi, njëjtë sikurse çdo palë tjetër e gëzon të drejtën e ushtrimit të së drejtës në ankesë dhe mjete tjera të jashtëzakonshme juridike, gjë të cilën edhe e ka bërë. Tutje gjyqtari ka deklaruar se janë të pavërteta dhe të pasakta pretendimet e paditësit për neglizhencë dhe njëanshmëri, për faktin që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme të shqyrtimit paraprak të padisë dhe palët ndërgjyqëse janë trajtuar njëjtë dhe të barabartë sikurse çdo palë tjetër në procedurë. Për më tepër, sipas tij janë të pasakta pretendimet për njëanshmëri për faktin që i njëjti nuk ka provuar çfarëdo veprimi apo sjellje me të cilën do të mund të tregojë njëanshmëri ndaj një Institucioni publik siç është Policia e Kosovës. Po ashtu ka kundërshtuar në tërësi pretendimet për përjashtim nga ky rast i gjykimit, për faktin që nuk ka asnjë arsye ligjore për tu bërë një gjë e tillë. Paditësi ashtu sikurse çdo palë tjetër, është trajtuar, trajtohet dhe do të vazhdojë të trajtohet nga ana jonë me respektin më të lartë, por vendimmarrja jonë gjithmonë do të bazohet ekskluzivisht në ligj.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit K.K.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për shkelje të ligjit a po për shkelje të detyrave të tij zyrtare si gjyqtar, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatojë se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit se gjyqtari K.K në rivendosje të çështjes në lidhje me lirim nga taksa gjyqësore nuk ka vendosur sipas udhëzimeve që janë dhënë nga Gjykata e Apelit, Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se nuk është kompetent dhe nuk ka të drejtën e komentimit të vendimeve të marra nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari i çështjes sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionin në fuqi.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarrë që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit

gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarëve a po mënyrën e trajtimit të lëndës nga ana e tyre. Nëse palët konsiderojnë se gjyqtari i çështjes ka shkelur dispozitat ligjore a po dispozitat procedurale të parapara me legjislacionin në fuqi a po nuk ka bërë zbatim të duhur të të drejtës materiale, atëherë palët gjithmonë udhëzohen në përdorimin e mjeteve të rregullta a po të jashtëzakonshme juridike për atakimin e vendimeve në shkallët më të larta, por vendimmarrja e gjyqtarit nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Për më tepër, nga gjyqtari jemi njoftuar se në lidhje me këtë lëndë gjyqësore është ende në vendosje e sipër në lidhje me kërkesën e të njëjtit për lirim nga taksa gjyqësore.

Andaj, për këto arsye Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që të gjitha veprimet e ndërmarra nga gjyqtari i çështjes janë veprime të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/07/24, me datë 11.04.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë